

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË RADIOTELEVISIONIT SHQIPTAR
(RTSH) PËR VITIN 2019

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e RTSH-së në drejtim të përmbushjes së misionit parësor për garantimin e shprehjes së interesave të publikut dhe rifitimin e besimit të tij te ky transmetues;

Duke njohur përpjekjet e RTSH-së për realizimin e programeve cilësore, të cilat pasqyrojnë të dëgjuesit dhe shikuesit e të gjitha moshave larminë e jetës shqiptare;

Duke konsideruar se veprimtaria e RTSH-së është kryer në përputhje të plotë me detyrimin për të pasur nga ana e saj një mbulim të paanshëm të lajmeve të vendit dhe të atyre ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e RTSH-së, për vitin 2019, në lidhje me:

- Transformimin e të gjitha programeve të RTSH-së në formë dhe në përmbajtje; aktualisht RTSH-ja transmeton një paketë programore të plotë prej 12 kanalesh TV dhe 6 kanale radio;

- Përshejtimin e ritmeve të punës për digjitalizimin e materialeve arkivore dhe kompletimit të ndërtimit të rrjetit numerik të shpërndarjes DVB T2 të RTSH-së;

- Vijimin e punës për prodhimin dhe transmetimin e programeve që u kushtohen proceseve integruese të vendit, në kuadër të çeljes së negociatave me Bashkimin Evropian, ku për vitin 2019 çështjet që lidhen me procesin integrues nuk janë trajtuar vetëm në edicionet informative, por edhe jashtë tyre, përmes intervistave të zgjeruara dhe emisioneve speciale, siç është edhe emisioni i përjavshëm “Shqiptarët dhe Europa”, që transmetohet në Radio Tiranë;

- Shtimin e shërbimeve në internet dhe rritjen e pjesëmarrjes në rrjetet sociale nëpërmjet hapjes së një llogarie në *Instagram*, rritjes së numrit të ndjekësve të faqes së RTSH-së në *Facebook* me mbi 20% ndjekës të rinj, dhe rritjes së numrit të abonentëve në kanalin *Youtube* me 10 mijë ndjekës të rinj;

- Forcimin e kapaciteteve administrative të stafit nëpërmjet organizimit të një numri të konsiderueshëm të trajnimeve për shumë departamente, si në teknikë, montazh, ku mund të përmenden 12 trajnime për temën “Sistemi i menaxhimit të aseteve media ETERE”, 3 trajnime të organizuara në bashkëpunim me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA), 2 programe trajnimi të organizuara në bashkëpunim me EBU-në dhe rreth 16 trajnime, seminare dhe vizita studimore nga punonjës të ndryshëm të RTSH-së, brenda dhe jashtë vendit, për tema si: për mbështetjen nga arkivi, prodhimin e programeve për fëmijë dhe të rinj, për zhvillimin e një mekanizmi ankesash për të përforcuar standardet editoriale në mediat publike etj.;

- Rritjen e profesionalizmit të qendrave vendore audiovizive, si në transmetimet lokale, për kronika, informacione apo pjesë të programeve, që mbulojnë hapësirat gjeografike të tyre, ashtu edhe në kronikat dhe pjesëmarrjen në programet e kanaleve kryesore të RTSH-së;

- Plotësimin e kuadrit rregullator të brendshëm me qëllim mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit, siç janë edhe hartimi dhe miratimi i rregulloreve të brendshme të drejtorive në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së, që kishin mbetur ende pa u miratuar, dhe i Qendrës Vendore Audiovizive Kukës.

Kuvendi kërkon që KDRTSH-ja dhe RTSH-ja, për vitin 2020, të përmirësojnë punën në këto drejtime:

- Të bëhet publikimi i vendimeve dhe materialeve të miratuara nga Këshilli Drejtues dhe organet e këshillat e tjera të RTSH-së, përfshirë Bordin e Administrimit dhe Këshillin për Shikuesit dhe Dëgjuesit, në funksion të transparencës dhe informimit të publikut, duke respektuar kufizimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale;

- Të përdoren të ardhurat e realizuara kryesisht për rritjen e fondit të rezervuar për prodhimin e programeve cilësore, të përgatitura nga prodhuesit e pavarur dhe të bëhet transparente çdo procedurë e përdorur për shpenzimet e këtij fondi;

- Të përfundojë procesi i hartimit të Strategjisë së Zhvillimit brenda muajit tetor të vitit 2020, si dhe t'i publikohet në fillim të çdo viti në faqen e internetit plani i biznesit, si dhe çdo 6 muaj situata financiare dhe matja e audiencës së RTSH-së; këto informacione të bëhen pjesë e raportit vjetor të veprimtarisë që i përcillet Kuvendit;

- Të sigurohet infrastruktura e nevojshme teknike dhe burimet njerëzore për funksionimin e kanalit të dedikuar RTSH Kuvend, me qëllim transmetimin e plotë të veprimtarisë parlamentare, pasurimin e programacionit me dokumentarë, realizimin e intervistave me deputetë dhe pasqyrimin e aktiviteteve të javës së gjelbër;

Gjithashtu, ritransmetimi i seancave plenare dhe i mbledhjeve të komisioneve parlamentare të realizohet në fashën e orareve që është e përshtatshme për audiencën e synuar.

- Të plotësohen të gjitha detyrimet që kanë ngelur pa u zbatuar në Kontratën e Shërbimit të Transmetimit Publik të lidhur me Autoritetin e Mediave Audiovizive, duke përfshirë hartimin dhe miratimin nga KDRTSH-ja të Aneksit nr.1, që jep informacion për pikat e transmetimit, frekuencat dhe karakteristikat e tjera teknike të rrjetit numerik dhe të rrjetit analog për transmetim audio, që do të shfrytëzohen nga RTSH-ja, si dhe transmetimin e të paktën një edicioni informativ brenda 24 orëve në gjuhën e shenjave, në kanalën gjeneralist RTSH 2;

- Të sigurohet mbulimi me sinjal transmetimi i atyre pjesëve të territorit, të cilat, sipas monitorimit dhe vlerësimit të bërë nga AMA, rezultojnë akoma me mungesë të sinjalit, si dhe të rritet cilësia dhe numri i kanaleve në transmetimet satelitore;

- Qendrat audiovizive vendore të angazhohen për përdorimin e shenjave paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në ato fasha orare kur ata mendohet se janë para ekranit, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi;

- Të angazhohen më shumë në planifikimin dhe menaxhimin më të mirë të të ardhurave, sidomos për grupin e të ardhurave nga zëri i reklamave dhe njoftimeve, duke pasur parasysh edhe problematikat që ka hasur sektori i marketingut në çdo media nga situata e COVID-19, si dhe një sërë aktiviteteve që janë anuluar;

- Të angazhohen në realizimin e më shumë emisioneve për fëmijë, siç mund të jenë emisionet për fëmijë të talentuar apo konkurset për fëmijë, si dhe në përfshirjen në programet televizive të RTSH-së edhe të rubrikave informative për fëmijët;

- Të vazhdojë procesi i punës së filluar për modernizimin e qendrave vendore audiovizive, ku në veçanti të shikohet mundësia për fillimin e transmetimeve televizive dhe për RTSH Shkodra, si dhe të orientohet puna e këtyre qendrave drejt prodhimit të programeve që trajtojnë temat e guximshme sociale, problemet që shqetësojnë qytetet apo fshatrat sipas zonave përkatëse, ku është qendra vendore audiovizive;

- Të angazhohen për transmetimin e programeve edukative, të parashikuara në dispozitat e ligjeve specifike për mbrojtjen e shëndetit, siç është dhe ligji nr. 76/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, 'Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit', i ndryshuar";

- Të angazhohen në krijimin e më shumë hapësirave për biseda, debate, që lidhen me përdorimin korrekt të gjuhës standarde shqipe, të folur e të shkruar, në institucionet shtetërore e jo vetëm, në bashkëpunim me institucionet akademike.

Miraturar në datën 2.7.2020.

KRYETAR
Gramoz Ruçi